



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:220788

Datë: 30.09.2024

Numri i dokumentit: 06232256

**C.nr.2119/21**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Shyqri Hoxha, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.K., A.G., A.I., A.S., A.L., nga Prizreni, kundër të paditues Komuna e Mamushës- Drejtoria Komunale e Arsimit, për çështjen juridike me objekt kontesti kompensimin e shtesave mbi bazën e kualifikimi-licencimit, vlera e kontestit 12,500 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 30 shtator 2024, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

### Pa shqyrtim kryesor të çështjes

**I. APROVOHET në tërësi** si e e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.K., A.G., A.I., A.S., A.L., nga Prizreni kundër të paditurës Komuna e Mamushës- Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.

**II. DETYROHET** e paditura, që në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, paditësve t'ua kompensoj shumat dhe atë:

- A.K. për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri më datë 18.04.2021 apo për 48 muaj (për çdo muaj shumën prej 38.95 euro, në shkallë prej 19 % të pagës bazë - 421 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej **1869.6 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (01.10.2021), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm
- A.G. për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri më datë 18.04.2021 apo për 48 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë - 421 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej **2656.8 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (01.10.2021), e deri në pagesën

definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

- A.I. për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri më datë 18.04.2021 apo për 48 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë - 421 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej **2656.8 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (01.10.2021), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- A.L. për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri më datë 18.04.2021 apo për 48 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë - 421 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej **2656.8 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (01.10.2021), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

**IV. DETYROHET** e paditura, që paditëseve, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 724.000 euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

### **A r s y e t i m**

Paditësit A.K., A.G., A.I., A.S., A.L., nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tyre av. A.K. kundër të paditues Komuna e Mamushës- Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 12,500 euro.

Në padi, i autorizuari i paditësve ka theksuar se paditësit janë të punësuar si mësimdhënës pranë ShFMU "Andalou", në Komunën e Mamushës, ku vazhdojnë të punojnë në këtë institucion. Tutje, ka theksuar se në bazë të Kontratës Kolektive të vitit 2017 paditësit i kanë plotësuar kushtet që në bazë të nenit 7 të kësaj kontrate, punëdhënësi Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren të ua bëjë kompensimin në bazë të kualifikimeve dhe licencimeve për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri më 18.04.2021, sa ka qenë në fuqi kontrata kolektive e arsimit. Andaj, i kanë propozuar gjykatës që të aprovohet e bazuar kërkesëpadija e paditësve, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit. Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

Me parashtresën e datës 28.07.2022, i autorizuari i paditësve ka bërë precizimin e kërkesëpadiisë, ashtu që ka kërkuar nga gjykata që të detyroj të paditurën Komuna e Prizrenit - DKA që paditësit A.K. për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri më datë 18.04.2021 apo për 48 muaj (për çdo muaj shumën prej 38.95 euro, në shkallë prej

19 % të pagës bazë - 421 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej **1869.6 euro**. Ndërsa për padiëtses A.G., A.I., A.S., A.L., për periudhën prej datës 18.04.2017 e deri më 18.04.2021, në emër të kompensimit mbi bazën e kualifikimit në lartësi prej 27% të pagës bazë të iu paguaj diferencën e mbetur seciles shumën prej 55.35 euro për 48 muaj që arrin lartësinë për secilin nga 2656.8 euro., me kamatë ligjore prej 8 %, nga data e parashtirmit të padisë deri në pagesën definitive. si Po ashtu me këtë parashtresë ka precizuar edhe shpenzimet e kërkuara procedurale dhe atë për taksë gjyqësore shumën prej 100 euro dhe për përpilimin e padisë shumën prej 724 euro.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditësve se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit - SBASHK-ut, ndërsa paditësit nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësit ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësit nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, ashtu që i janë drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 par. 6.1. të Ligjit për Procedurën Administrative, dhe me këto veprime të paditurës i shkaktojnë shpenzime të mëdha, sepse obligohen të paguajnë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK-së, andaj Komuna e Mamushës nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK-ja.. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësës është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësit A.K., A.G., A.I., A.S., A.L., që të gjithë nga Prizreni pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë ShFMU "Andalou", në Komunën e Mamushës. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësve u takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar.

Në këtë drejtim, gjykata përmes diplomës me numër 376 të datës 18.04.1990 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukatës Fizike, vërtetoi faktin se paditësi A.K. ka përfunduar Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe ka marrë titullin "Mësues i Edukatës Fizike", ndërsa me licencën nr.100020433 i njëjti me datë 20.05.2014 është

licencuar si mësimdhënës. Po ashtu nga kontrata me numër të protokollit 009/15 të datës 01.09.2015, gjykata vërtetoi faktin se paditësi me të paditurën janë në raporte kontraktuale në mes vete, ku paditësi ka pozitën e mësimdhënësit të edukatës fizike pranë të paditurës.

Gjykata përmes diplomës me numër 181 të datës 25 janar 2010 e lëshuar nga Universiteti Prishtinës, Fakulteti i Edukimit në Prishtinë, vërtetoi faktin se paditësja A.( A ) Sh. G. ka diplomuar dhe ka marrë titullin bachelor i gjuhës dhe letërsisë angleze, ndërsa me licencën nr,100009999, e njëjta me datë 28.05.2013 është licencuar si mësimdhënëse. Po ashtu nga kontrata me numër të protokollit 012/15 të datës 01.09.2015, gjykata vërtetoi faktin se paditësja me të paditurën janë në raporte kontraktuale në mes vete, ku paditësja ka pozitën e mësimdhënëses së gjuhës angleze pranë të paditurës.

Gjykata përmes diplomës me numër 1086 të datës 16 shtator 2014 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimi-Qendra në Prizren, vërtetoi faktin se paditësja A. ( R ) B.I. ka diplomuar dhe ka marrë titullin bachelor i gjuhës dhe letërsisë angleze, ndërsa me licencën nr,100011574, e njëjta me datë 01.03.2013 është licencuar si mësimdhënëse. Po ashtu nga kontrata me numër të protokollit 008/15 të datës 01.11.2015, gjykata vërtetoi faktin se paditësja me të paditurën janë në raporte kontraktuale në mes vete, ku paditësja ka pozitën e mësimdhënëses së gjuhës angleze pranë të paditurës.

Gjykata përmes diplomës me numër 1086 të datës 16 shtator 2014 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit-Qendra në Prizren, vërtetoi faktin se paditësja A. (R) B.I. ka diplomuar dhe ka marrë titullin bachelor i gjuhës dhe letërsisë angleze, ndërsa me licencën nr,100011574, e njëjta me datë 01.03.2013 është licencuar si mësimdhënëse. Po ashtu nga kontrata me numër të protokollit 008/15 të datës 01.11.2015, gjykata vërtetoi faktin se paditësja me të paditurën janë në raporte kontraktuale në mes vete, ku paditësja ka pozitën e mësimdhënëses së gjuhës angleze pranë të paditurës.

Gjykata përmes diplomës me numër 620 të datës 20 qershor 2012 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit në Prishtinë, vërtetoi faktin se paditësja A.(S) B.S. ka diplomuar dhe ka marrë titullin bachelor i mësimit klasor, ndërsa me licencën nr,100011237, e njëjta me datë 01.03.2013 është licencuar si mësimdhënëse. Po ashtu nga kontrata me numër të protokollit 013/2015 të datës 01.09.2015, gjykata vërtetoi faktin se paditësja me të paditurën janë në raporte kontraktuale në mes vete, ku paditësja ka pozitën e mësimdhënëses së mësimit klasor pranë të paditurës.

Gjykata përmes diplomës me numër 202 të datës 05 shkurt 2015 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit-Qendra në Prizren, vërtetoi faktin se paditësja A. (R) L. ka diplomuar dhe ka marrë titullin bachelor i programit fillor, ndërsa me licencën nr,100010079, e njëjta me datë 28.05.2013 është licencuar si mësimdhënëse. Po ashtu nga kontrata me numër të protokollit 010/2015 të datës 01.09.2015, gjykata vërtetoi faktin se paditësja me të paditurën janë në raporte kontraktuale në mes vete, ku paditësja ka pozitën e mësimdhënëses së mësimit klasor pranë të paditurës.

Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësve, A.G., A.I., A.S., A.L., është në shumë prej 421.00 euro, dhe se paditësve në emër të kualifikimit me diplomë universitare, në pagën bazë mujore iu është paguar shuma prej 58.32 euro, ndërsa paditësit A.K. në bazë të pagës bazë prej 421,00 euro, në emër të kualifikimit i është paguar shuma prej 41.04 euro, pasi që i njëjti ka të kryer Shkollën e Lartë Pedagogjike.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësve t’ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontratat e punës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, iu ka paguar paditësve A.G., A.I., A.S., A.L., prej 58.32 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 3 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësit përfitojnë ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret paditëset A.K., A.G., A.I., A.S., A.L., përfitojnë ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumë prej 113.67 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësve S.Sh., E.V.,N.G. për çdo muaj t’iu paguaj shumën

prej 55.35 euro apo diferencën e mbetur për 48 muaj nga data 0118.04.2017 deri më datë 18.04.2021, secilit paditës në shumë të përgjithshme prej **1549.8 euro** ( $48 \cdot 55.35 = 2656.8$ ). Ndërsa për paditësin A.K.e paditura ka për obligim që në bazë të kualifikimit - nivelit shkollor pasi që i njëjti ka të kryer Shkollën e Lartë Pedagogjike, dhe se nga lista e pagave vërtetohet fakti se i njëjti nga e paditura në emër të kulafikimit ka pranuar shumën prej 41.04 euro në muaj, ndërsa sipas pikës 4 nën pika 2 të vendimit të lartcitur, paditësi përfiton ngritje prej 19\*% të pagës bazë, e që në rastin konkret paditësi përfiton ngritje në pagën bazë në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 79.99 euro. Andaj gjykata vendosi si në pikën nën I të këtij dispozitivi të këtij aktgjykimi, që për cdo muaj të ia paguaj diferencën e papaguar në shumën prej 38.95 euro për 48 muaj nga data 0118.04.2017 deri më datë 18.04.2021, secilit paditës në shumë të përgjithshme prej **1549.8 euro** ( $48 \cdot 38.95 = 1869.6$ ).

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadsisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*, andaj ka vendosur si në pikën nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padsisë në këtë gjykatë (01.10.2021), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par.1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 724 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padsisë shumën prej 324 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 100.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143 dhe 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**

**C.nr.2119/21, datë 30 shtator 2024**

**G j y q t a r i**  
**Shyqri Hoxha**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.